




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



ARTMOTION
Valon SHALA
Drejtor
Prishtinë

Ref:1911/1290/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2019/47 ARTMOTION (Palë Ankuese) kundër Operatorëve të Shpërndarjes: KUJTESA NET, TELKOS, BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIA NET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS, ISPBROADCAST.

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM, me datën 4 korrik 2019 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Pala Ankuese ndaj operatorëve të shpërndarjes: KUJTESA NET, TELKOS, BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIA NET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS dhe ISP BROADCAST. Pala Ankuese pretendon se këta operatorë të shpërndarjes janë duke e ritransmetuar kanalën ALSAT M pa të drejta të ritransmetimit, kanal për të cilin Pala Ankuese posedon të drejtat ekskluzive të transmetimit për territorin e Republikës së Kosovës.
3. KPM, gjithashtu me datën 18 korrik 2019, ka pranuar një shkresë nga ALSAT M, përmes të cilës KPM është njoftuar se ALSAT M ka bërë shkëputjen e kontratës me operatorin e shpërndarjes Kujtesa Net dhe Koscable nëpërmjet së cilës kontratë me Koscable e kanë siguruar të drejtën e ritransmetimit të kanalit ALSAT-M për territorin e Republikës së Kosovës operatorët e shpërndarjes: TELKOS, BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIANET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS, ISPBROADCAST.
4. KPM, nëpërmes shkresave të cilat iu ka dërguar operatorëve të shpërndarjes me datën 16 dhe 19 gusht 2019, i ka njoftuar operatorët e shpërndarjes: KUJTESA NET, TELKOS,

BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIANET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS dhe ISP BROADCAST për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e i ka udhëzuar që brenda afati dhjetë ditësh të ofrojnë dëshmi shtesë për të drejtën e ritransmetimit të kanalit ALSAT M.

5. KPM ka pranuar përgjigje nga ana e operatorëve të shpërndarjes saktësisht nga Kujtesa Net lidhur me shkresën duke cekur se kontratën me ALSAT M e kanë valide dhe së në bazë të kontratës së rideponuar në KPM, vërehet se Kujtesa Net ka siguruar kontratë valide me Alsat M e cila është e lidhur me datën 1 janar 2018, e vlefshme për periudhën dy (2) vjeçare nga data e nënshkrimit.
6. KPM, gjithashtu ka pranuar përgjigje edhe nga KOSCABLE e cila potencon se kontrata me ALSAT M është e vlefshme dhe se operatorët e shpërndarjes: TELKOS, BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIANET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS dhe ISP BROADCAST e kanë të drejtën e ritransmetimit të kanalit ALSAT M për territorin e Republikës së Kosovës. Në bazë të dëshmisë së deponuar nga KOSCABLE në KPM vërehet se ky subjekt ka siguruar të drejtën e transmetimit për kanalit Alsat M deri me datën 31 dhjetor 2020.

Analiza Ligjore

7. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se operatorët e shpërndarjes: KUJTESA NET, TELKOS, BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIA NET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS dhe ISP BROADCAST, kanë siguruar marrëveshje përmes të cilave dëshmojnë se posedojnë të drejtën e transmetimit të kanalit ALSAT M për territorin e Republikës së Kosovës, ashtu siç kërkohet me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.”

8. KPM, bazuar në kontratat e deponuara nga operatorët e shpërndarjes: KUJTESA NET, TELKOS, BLEDI, FIBERLINK, GALAKTIKA, KADRIA NET, KUMANOVA CABLE, TELCOMUNNICATIONS dhe ISP BROADCAST, të cilët e transmetojnë kanalit ALSAT M në territorin e Republikës së Kosovës, ka konstatuar se këta operatorë të shpërndarjes kanë siguruar marrëveshje valide nga dhënësi i të drejtave për transmetimin e kanalit ALSAT në territorin e Republikës së Kosovës.
9. KPM, gjen se operatorët e shpërndarjes kundër të cilëve është parashtruar ankesë nga Pala Ankuese janë në pajshëm me Rregulloren KPM-2016/01, pasi që kanë siguruar të drejta valide të transmetimit nga dhënësi i të drejtave dhe rrjedhimisht pretendimet e palës ankuese së këta operator janë duke transmetuar kanalit Alsat M pa të drejtë të transmetimit nuk qëndrojnë.

